



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Kom.Dh.Shk.II.nr.1301/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen përmbartimore të kreditorit sh.p.k, me seli nga fshati – Komuna e Vitisë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Liman Musa, avokat në Ferizaj, rr. “Rruga e Reçakut” ndaj debitorit, me seli në– Komuna e Gjilanit, përfaqësuar nga pronari M.G., për shkak të borxhit, në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm CPK.nr.48/2021 të dt. 22.09.2021 dhe dt.12.10.2021(aktvendimi korigjues), jashtë seancës me datën 24.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit me seli në Komuna e Gjilanit, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm CPK.nr.48/2021 të dt. 22.09.2021 dhe dt. 12.10.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me Aktvendimin e atakuar, CPK.nr.48/2021 të dt. 22.09.2021, ka vendosur si në vijim: I. Refuzohet si i pa bazuar prapësimi i datës 19.04.2021, të debitorit “...”, me seli në, K.Gjilan, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.201/21 të dt. 02.04.2021 të Përmbartuesit Privat Besnik Aliu. II. Mbetet në fuqi urdhri përmbartimor P.nr.201/21 dt. 02.04.2021 të Përmbartuesit Privat.III. Obligohet debitori që në emër të taksës gjyqësore për ushtrim të prapësimit, të paguaj shumën prej 40 euro, në xhirrollogarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, konform nenit 12.1 të Udhëzimit Administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore Nr. 01/2017. IV. Në rast të ushtrimit të ankesës kundër këtij aktvendimi, obligohet debitori që të deponoj shumën e të hollave në lartësi prej 500 euro, në emër të garancisë duke u bazuar në nenin 78 të LPP –së. Nëse debitori dështon të paguaj shumën e garancisë të caktuar nga gjykata, ankesa konsiderohet se nuk është dorëzuar fare në gjykatë”.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin korigjues të CPK.nr.48/21 të dt. 12.10.2021, ka korigjuar aktvendimin CPK.nr.48/21 të dt. 22.09.2021, ashtu që ku është shkruar P.nr.48/21

e ka hequr dhe ka konstatuar se duhet të jetë P.nr.201/21, ndërsa pjesën tjetër të aktvendimin e ka lën të pa ndryshuar.

Kundër këtyre aktvendimeve, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak shkeljeve substanciale të dispozitave të ligjit të procedurës përbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për gjykatën e shkallës së dytë, të aprovet ankesa e debitorit e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan CPK.nr.48/21 të dt.22.09.2021 si i pa bazë dhe të detyrohet përbaruesi privat ti anulohet të gjitha veprimet e ndërmarra. Si dhe ka kërkuar të anulohet në tërësi aktvendimi i atakuar si i pa bazë dhe ti paguhet shpenzimet e procedurës përbarimore debitorit.

Ankesa i është dërguar në mënyrë të rregullt të autorizuarit së kreditorit, por e njëjta nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale–Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori sh.p.k, me seli nga fshati– Komuna e Vitisë ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit, me seli në Komuna e Gjilanit, në bazë të dokumentit të besueshëm–Faturës me nr. e dt. 24.05. 2019, për shumën e detyrimit në vlerë prej 4,249.33 €, me kamatë ligjore prej 8%, nga data 02.06.2019, e deri në pagesën definitive. Si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore i ka kërkuar.

Përbaruesi Privat Besnik H. Aliu me seli në Ferizaj, me Urdhrit Përbarimor P.nr.201/21 të dt.02.04.2021, ka caktuar përbarimin, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm– fatura e lartcekur, i plotëson kushtet për përbarim.

Ndaj këtij urdhri me dt.19.04.2021, ka paraqitur prapësim debitori, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Ligjit të Procedurës Përbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet prapësimi i debitorit, kundër urdhrit për përbarim të përbaruesit privat Besnik Aliu P.nr.201/2021 të dt.02.04.2021, të detyrohet përbaruesi privat ti anulohet të gjitha veprimet e ndërmarra. Të refuzohet në tërësi urdhri përbarimor si i pa bazë dhe ti paguhet debitorit shpenzimet për përfaqësim në vlerë prej 156 euro. Përgjigje në prapësim ka paraqitur i autorizuari i kreditorit, me dt.20.04.2021, duke i propozuar gjykatës që të refuzohet si e pa bazur prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri për përbarim i përbaruesit Privat Besnik Aliu, të vërtetohet si dhe gjykata ta obligoj debitorin që në rast ankese të paguaj garancionin konform nenit 78 të LPP –së.

Gjykata Themelore në Gjiçan, me aktvendimin e atakuar, CPK.nr.48/2021 të dt. 22.09.2021, ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht sikur në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, refuzoj prapësimin e debitorit, për shkak se i njëjti nuk i përmbush asnjë nga kushtet e parapara të nenit 71 të LPP –së, sepse fatura me nr..... e dt. 24.05. 2019, në bazë të së cilës është bazuar propozimi për përmbarim dhe pastaj nga ana e Përmbaruesit Privat është lejuar urdhri për përmbarim është dokument i besueshëm – titull ekzekutiv, konform nenit 29 par 1 nën par 1.3 dhe par 3 të LPP –së, si dhe në rastin konkret fatura është pranuar dhe nënshkruar nga debitori, po ashtu debitori nuk ka paraqitur prova se ka kryer pagesën sipas faturës në fjalë.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore se dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues nuk ka titull ekzekutiv, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përmbarimore, përkatësisht neni 29 par 1. nën par.1.3 dhe par 3 i cili përcakton se: “ *Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: fatura. Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar* ”. Gjithashtu neni 37 dhe 40 par.1 pika 3 i LPP-së, përcakton se propozimi për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë “*originalin apo kopjen e vërtetuar e dokumentit të besueshëm*”, e në rastin konkret fatura po ashtu edhe propozimi i përmban të gjitha elementet e kërkuara nga dispozitat e lartpërmendura, andaj si i tillë dokumenti i besueshëm përmban tiparet e nevojshme të përmbarueshmërisë të përcaktuar sipas dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Debitori ne prapësim nuk ka ofruar ndonjë argument apo provë me të cilën kishte me paraqitur ndonjë nga shkaqet që janë të parapara me nenin 71 te LPP-së.

Duke u mbështetur ne nenin 69 par.4 te LPP “*baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet*”, me çka debitori nuk ka ofruar ndonjë provë për të vërtetuar të kundërtën e kreditorit, por edhe pretendimet e vetë debitorit në prapësim.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera

ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet tjera ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka lejuar urdhrin për caktimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat, P.nr.201/21 dt. 02.04.2021.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.1301/22 dt. 24.08.2022

Gjyqtari,
Krenar Berisha